

LIGJ

Nr. 8902, date 23.5.2002

PER RATIFIKIMIN E "MARREVESHJES NDERMJET REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE SELISE SE SHENJTE PER RREGULLIMIN E MARREDHENIEVE TE
NDERSJELLA "

Ne mbështetje te neneve 10 pika 5, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI

V E N D O S I:

Neni

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Selisë se Shenjte për rregullimin e marrëdhënieve te ndërsjella " .

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3371, date 14.6.2002 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë,
Rexhep Meidani

MARREVESHJE

NDERMJET REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE SELISE SE SHENJTE ,
PER RREGULLIMIN E MARREDHENIEVE RECIPROKE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjte, duke pasur dëshirën e përbashkët për te forcuar dhe zhvilluar, ne frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre, dhe me qëllimin për te rregulluar përmes një marrëveshjeje te përbashkët statusin juridik te Kishës Katolike ne Shqipëri,
bien dakord si me poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për te shpallur dhe praktikuar ne publik Fenë Katolike.
Kisha Katolike ne Shqipëri ka te drejte te organizohet dhe te plotësojë misionin e sat

Neni 2

Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike te personave ligjore për entitete te tilla te Kishës Katolike, te cilat janë te parashikuara ne te Drejtën Kanonike, si arkidieqezat, dieqezat apo administraturat apostolike famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat,

seminaret, shkollat dhe institucionet arsimore te te gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, pas regjistrimit te tyre nga organet e drejtësisë.

Neni 3

Selia e Shenjte dhe Kisha Katolike ne Shqipëri gëzojnë lirinë e plote te komunikimit dhe te korrespondencës me njëra-tjetrën.

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjte do te mbajnë marrëdhënie diplomatike ne nivelin e Ambasadës dhe Nunciatures Apostolike.

Neni 4

Kisha Katolike ka te drejtën te posedoje mjete te veta te komunikimit masiv dhe ka te drejtën te përdorë mjetet publike te komunikimit masiv, ne përputhje me legjislacionin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka te drejte te krijojë strukturat përkatëse te Kishës, e ne veçanti, te krijojë dhe te modifikojë personat juridike kishtarë, ne përputhje me te Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjte është e lire te zgjedhe një klerik ne detyrën e Ipeskvit ose te Administratorit Apostolik, i cili mund te jete dhe Ipeshkëv.

Përpara se te publikojë emërimin e Ipeskvit apo te Administratorit Apostolik, Selia e Shenjte, për mirësjellje dhe ne konfidence, do te informoje Presidentin e Republikës se Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë se Punëve te Jashtme.

Neni 6

Për te plotësuar përgjegjësitë qe rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka te drejte te ftojë ne Shqipëri priftërinj, anëtarë te kongregacioneve rregullatorë dhe persona laike, te cilët nuk kane nënshtetësinë shqiptare dhe te rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidence dhe për leje për pune drejtuar autoriteteve shqiptare, ne përputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë.

Me kërkesën formale te Ipeskvit ose te Administratorit Apostolik, leja për rezidence dhe leja për pune, e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor, do te lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

Neni 7

Kisha Katolike ka te drejte te hape dhe te drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale te saj sipas te Drejtës Kanonike dhe ne përputhje me ligjet përkatëse te Republikës se Shqipërisë .

Neni 8

Republika e Shqipërisë do te ktheje pronat e Kishës Katolike, ne përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do te asistojë reregjistrimin e tyre ne emrin e Kishës Katolike ne zyrat kompetente shtetërore.

Neni 9

Ne rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision "ad hoc" të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme, që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjte do të procedojnë një marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësim nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari nëntëdhjetë (90) dite pas ditës së njoftimit.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Selinë e Shenjte